



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION




Me qëllim të rishikimit të kriterëve dhe procedurave për lëshimin e licencave për Ofrues të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale me transmetim përmes rrjetit të Operatorëve të Shpërndarjes, bazuar në Ligjin për KPM-në, Neni 3, paragrafi 1, pika 2.1, 2.4 dhe 2.6, Neni 9, Neni 22, paragrafi 5 dhe Neni 23, paragrafin 1, dhe 3, Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) nxjerr këtë:

VENDIM

- I. **PEZULLOHET** përkohësisht lëshimi i licencave për Ofrues të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale me transmetim përmes rrjetit të Operatorëve të Shpërndarjes, deri në përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të reja për licencimin e tyre.
- II. **TË INICOHEN** procedurat për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (KPM-2017/02).


Arsyetimi

- III. Licencat e KPM-së për Ofrues të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (OSHMA) me transmetim përmes rrjetit të Operatorëve të Shpërndarjes, lëshohen në pajtim me kriteret për licencë të përcaktuara me Ligjin për KPM-në si dhe në pajtim me procedurat dhe kriteret e përcaktuara me Rregulloren për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (KPM-2017/02).
- IV. Bazuar në Rregulloren për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (Rregullorja KPM-2017/02), kandidatët e interesuar për këtë lloj të licencës mund të aplikojnë në çdo kohë dhe pa iu nënshtruar procesit të konkurrimit.
- V. Në pajtim me Nenin 23, paragrafin 1, të Ligjit për KPM-në, në rast të lëshimit të licencave të reja për shërbime mediale audiovizuale, KPM është e obliguar që ta publikojë një njoftim për këtë qëllim, ndërsa në pajtim me paragrafin 3 të këtij neni është e obliguar që licencat t'i lëshojë mbi baza të konkurrimit.
- VI. Komisioni vlerëson se lëshimi i licencave të reja për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale me transmetim përmes Operatorëve të Shpërndarjes, sikurse edhe ato me transmetim tokësor, duhet të bëhet përmes procesit të konkurrimit, prandaj vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.



VII. KPM nuk do të shqyrtojë aplikacionet për Licencë të KPM-së, për Ofrues të Shërbimeve Mediale Audio dhe Adiovizuale, të dorzuara pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

VIII. Vendimi hyn në fuqi 15 ditë nga data e nënshkrimit.



Xhevat LATIFI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediale



23.03.2021
data